



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Nr. 2126/6 Prot.

Tiranë, më 08 . 07 . 2024

## URDHËR

Nr. 137 , datë 07 . 07 . 2024

### PËR

### NJË NDRYSHIM NË URDHËRIN NR. 120, DATË 19.06.2024 “PËR PËRCAKTIMIN E AFATEVE TË REGJISTRIMEVE TË NXËNËSVE”

Në zbatim të Urdhërit Nr. 300, datë 19.06.2024 “Për disa ndryshime në Urdhërin Nr. 31, datë 28.01.2020, “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”.

### URDHËROJ:

1. Pika 1 e Urdhrit Nr. 120, datë 19.06.2024 “Për përcaktimin e afateve të regjistrimeve të nxënësve”, ndryshon si më poshtë:
  - Regjistrimi në klasën e parë dhe në klasën e dhjetë bëhet nëpërmjet portalit e-albania, nga 08 Korrik-31 Gusht 2024.
  - Regjistrimi në shkollat artistike dhe ato sportive bëhet nëpërmjet portalit e-albania, nga 08 Korrik-31 Gusht 2024.
2. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohen Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar, Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar si dhe institucionet publike/private të arsimit parauniversitar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

### DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Rezarta Alla

